Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Đakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
16 Nr./Br. 400/04-7967
Data 30. 03. 2018
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

FORMULARI 3 – THIRRJE PUBLIKE [illegible] MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË ZBATIMIN E AKTIVITETVE NË SEKTORIN E KOMUNITETEVE

Gjakovë – 30.03.2018

1.Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) e komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare që vijnë nga radhët e komuniteteve joshumicë (Rome Ashkali, Egjiptian) të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e sektorit të Komuniteteve pakicë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e programit të ZKKK-së së komunës së Gjakovës që i dedikohet sektorit të promovimit dhe integrimit të komuniteteve.

2.OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt/programe e tyre për fushat prioritare si në vijim:

1. **E drejta e informimit për komunitetet dhe qasja në media.**
2. **Projektet që promovojnë të drejtat e komuniteteve, kulturen dhe integrimin e tyre, qasjen e tyre në shërbimet publike dhe parandalimin e fenomeneve negative si dhe projekte që ndërlidhen me fushën e integrimit të komuniteteve në Komunen e Gjakovës.**

3.Organizatat jo-qeveritare të udhëhequra nga komunitetet pakicë në komunën e Gjakovës mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në zbatimin e aktivitetit në sektorin e Komuniteteve përmes aktiviteteve si me poshtë:

✓Aktivitetet që kanë për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve,
✓Aktiviteti në fushën e medias përmes emisioneve radio televizive me qëllim informimi të komuniteteve;
✓Aktivitetet lidhur me avokimin dhe aktivizmin e komuniteteve;
✓Aktiviteti i organizimit të fushatave vetëdijësuese për parandalimin e përdorimit të narkotikëve, për vetëdijësimin e
✓Aktivitete për identifikimin e të rinjëve (djem dhe vajza ) me kualifikime të shkollimit dhe aftësimit profesional si dhe bizneseve nga radhët e komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptian .

4.Vlera totale e planifikuar e thirrjes dhe e mbështetjes është: 8,000.00 euro.
Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për këto projekte individuale është 500,00 Euro, ndërsa shuma maksimale për këto projekte nuk do ta kalojë vlerën e 2,000.00 Euro.

5.Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën: **20.04.2018.**

6.OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit 2018. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vitë para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën komuniteteve. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-ve në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7.Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit (https://kk.rks-gov.net/gjakova/), si dhe mund ti merrni personalisht në ZKKK..

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:
Adresa: Rr. “Nena Tereze” Nr 469, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës/Zyrat e ZKKK-së në Kuvendin e Komunës.
Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve: që kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin e sektorit të integrimit të komuniteteve në komunën e Gjakovës.
Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8.Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: pranvera.kershi@rks-gov.net.

*Gjakovë*

*Armend Behluli Shef i ZKKK-së*
*Nënshkrimi:*

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim - Gjakovë